



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENSIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE


**RAPORT PËRMBLEDHËS**  
**I ECURISË SË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE (2014-2015)**

**A. ECURIA E TREGUESVE TË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE.**

**1. Pranimi i aplikimeve të reja për shkak të ndryshimeve ligjore.**

Në mënyrë analitike numri i aplikimeve sipas viteve dhe qarqeve të vendit, paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim:

DREJTORIA	2005	2006	2013	2014	2015	TOTAL
BERAT	2.249	5.304	520	8.077	462	16.612
DIBËR	65	1.414	181	2.300	272	4.232
DURRËS	13.233	24.690	4.574	24.708	2.500	69.705
ELBASAN	6.808	11.920	3.756	22.286	1.193	45.963
FIER	2.556	25.996	1.935	24.862	1.290	56.639
GJIROKASTËR	190	1.738	199	2.660	513	5.300
KORÇË	3.828	5.749	1.033	6.393	800	17.803
KUKËS	201	1.816	181	1.452	175	3.825
LEZHË	2.701	8.258	2.357	8.910	1.088	23.314
SHKODËR	1.527	16.953	2.691	12.983	1.050	35.204
VLORË	6.696	16.297	2.497	10.797	1.268	37.555
TIRANË	23.946	61.652	4.130	37.045	3.136	129.909
<b>TOTAL</b>	<b>64.000</b>	<b>181.787</b>	<b>24.054</b>	<b>162.473</b>	<b>13.747</b>	<b>446.061</b>




## 2. Procedurat e përditësimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit.

Për të njëjtin hark kohor, është kryer evidentimi faktik në terren për **124.332** ndërtime pa leje. Kjo procedure, përfshin përditësimin në terren të gjendjes ndërtimore dhe plotësimin e hartimit e dokumentacionit tekniko-ligjor (proces verbal, genplan, planimetri, hartë e përditësuar e zonës kadastrale, etj.).

Sikurse vihet re nga tabela në vijim, në 19 muaj, është tejkaluar me 2,7 herë, ritmi i përditësimeve të kryera në 8 vitet e mëparshme.

Duke patur parasysh numrin e lartë të aplikimeve për legalizim dhe rëndësinë që ka etapa e përditësimit në terren, për të siguruar vazhdimësinë e procedurave të legalizimit, pritet që në përfundim të vitit 2015, të shtohen edhe 15.000 objekte të përditësuara, nëpërmjet prokurimit të këtij shërbimi me fonde të arkëtuara nga parcela ndërtimore.

PERDITESIMET SIPAS VITEVE			
2006 - 2013	2014	2015	2014-2015
<b>46.037</b>	<b>64.138</b>	<b>60.194</b>	<b>124.332</b>



## 3. Procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë dhe kompensimit të pronarëve.

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nga strukturat përgjegjëse, është hartuar dokumentacioni i nevojshëm i cili ka rezultuar në miratimin nga Këshilli i Ministrave të:

- Kalimit të së drejtës së pronësisë për **4.944 parcela ndërtimore**, të zëna nga ndërtimet pa leje;
- Shpërblimit financiar të **499 subjekteve**, pronarë të pasurive të paluajtshme, të prekura nga ndërtimet pa leje.

Nga vlera (rreth 1.9 miliard lekë) e mbledhur nëpërmjet kalimit të së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore për periudhën 2014-2015, janë transferuar në fondin special të kompensimit, afro 1.3 miliardë lekë të cilat përdoren për shpërblimin e pronarëve, pronat e të cilëve janë zënë nga ndërtimet pa leje.

LEKË	2014	2015	TOTAL
ARKETIME	315.631.249	1.579.650.775	1.895.282.060
FONDE TË TRANSFERUARA	238.740.982	1.105.755.568	1.344.496.550

#### 4. Lejet e legalizimit

**Gjithsej leje legalizimi të dhëna në periudhën 2006-2015, janë 57.000 leje.**


Me ndryshimet që pësoi ligji nr.9482/2006 në vitin 2014 dhe 2015 dhe me miratimin e kuadrit të plotë të akteve nënligjore, u bë i mundur përsheptimi i ritmeve të procesit të legalizimit duke mundësuar legalizimin e **15.294** ndërtimeve në vitin 2014 dhe **19.714** të tjerave për periudhën janar-26 tetor 2015.

Numri i lejeve të dhëna në më pak se dy vite (**35.008 në 19 muaj**), është rreth 1.5 herë më i madh se sa lejet e dhëna në 8 vitet e qeverisjes së mëparshme.


Tabela dhe grafiku në vijim paraqesin numrin dhe përqindjen e lejeve të legalizimit të lëshuara sipas viteve.

NR. I LEJEVE TE LEGALIZIMIT SIPAS VITEVE							
2006-2009	2010	2011	2012	2013	2014	01-10 2015	2014-2015
2.023	1.819	3.625	6.507	7.776	15.294	19.714	35.008

TABELA E LEJEVE TË LEGALIZIMIT SIPAS VITEVE



PARAQITJE GRAFIKE E LEJEVE TË LEGALIZIMIT NË VITE



Vlen të përmendim ecurinë e kënaqshme për këtë tregues, në drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t për qarkun Durrës, Tiranë dhe Fier.

## B. MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE

Bazuar në përcaktimet e nenit 25 të ligjit nr. 50/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”, Këshilli i Ministrave është ngarkuar me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 6, 13, 14, 17, 20, 22, 23 dhe 24, të këtij ligji. Në zbatim të dispozitës së mësipërme, ALUIZNI është përfshirë në procesin e hartimit të projekt-akteve përkatëse. Aktet e miratuara dhe gjendja e projektakteve të hartuar paraqiten në vijim.

### **Akte të miratuara.**

1. VKM nr.439, datë 02.07.2014 “Për përcaktimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje, shtesave anësore apo në lartësi, të ndërtuara nga shoqëria “Hawai-alb” shpk”.
2. VKM nr. 466, datë 09.07.2014 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë të parcelave ndërtimore nga shteti në favor të poseduesve të objekteve informale”.
3. VKM nr. 488, datë 22.07.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës” (në bazë të nenit 6 të ligjit).
4. VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për evidentimin faktik në situatës ndërtimore në terren, si dhe të periudhës kohore brenda së cilës janë ndërtuar objektet pa leje” (në bazë të nenit 24 të ligjit).
5. VKM nr.860 datë 10.12.2014 “Për mënyrën e mbledhjes së të ardhurave, vlerën e tarifës së shërbimit dhe administrimin e saj”.

6. VKM nr.860 datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e çmimit minimal fiskal dhe vlerës së tregut për efekt të penaliteteve për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues” (në bazë të nenit 22 të ligjit).

7. Gjashtë VKM “Për shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”.

8. Shtatë VKM “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”.

9. VKM nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

10. VKM nr.332, datë 12.3.2008 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përfutur nga fotografimi ajror, dixhital, i territorit të Republikës së Shqipërisë”.

#### **Akte në proces miratimi.**

1. VKM “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit të punës ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së dhe të procedurave, apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”.

2. VKM Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formularit të lejes së legalizimit”.

3. VKM “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”.

### **C. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE BURIMET NJERËZORE.**

Me Urdhërin nr. 111, 06.08.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe drejtorive në varësi të saj” është riorganizuar Agjencia, me fokus kryesor:

- Rritjen e efikasitetit të strukturave, në funksion të përsheptimit të procedurave administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje,
- Shkurtimin e shpenzimeve buxhetore të tepërta nëpërmjet rekrutimit të specialistëve me profilin e duhur arsimor
- Transferimin e shërbimit sa më pranë qytetarit duke shpërndarë në territor një numër të konsiderueshëm ekspertësh.

Krahas **18** drejtorive ekzekutive, ALUIZNI ka krijuar një rrjet të zgjeruar të zyrave, pranë njësive të veçanta të qeverisjes vendore, duke ngritur 14 të tilla në të gjithë vendin.

<b>DREJTORIA</b>	<b>ZYRË VARTESIE</b>
Qarku Durrës	<b>Krujë</b> Shijak, Fushë Krujë, Rashbull
Qarku Elbasan	Librazhd
Qarku Korçë	<b>Pogradec</b>
Qarku Shkodër	<b>Malësi e Madhe</b>
Qarku Tiranë	<b>Kavajë</b> Kamëz, Vorë, Paskuqan, Fruti-Kulturë, Bathore, Kashar